



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 9 prill 2016
Nr. ref.:RK915/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI87/15

Parashtrues

Bahrije Galica

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
Rev. nr. 277/2014, të 20 nëntorit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare,
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është znj. Bahrije Galica, të cilën e përfaqëson z. Naim Krasniqi, avokat në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 277/2014, i 20 nëntorit 2014.
3. Parashtruesja e kërkesës e ka pranuar aktgjykimin e kontestuar më 2 janar 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjyimit të lartpërmendur të Gjykatës Supreme, për të cilin parashtruesja pretendon se i është shkelur e drejta e saj e garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 1, të Protokollit nr. 1, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 26 qershor 2015, parashtruesja e kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 3 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR. KI87/15, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja, me Vendimin KSH. KI87/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Artta Rama-Hajrizi dhe Bekim Sejdiu.
8. Më 19 gusht 2015, Gjykata njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
9. Më 19 gusht 2015, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë të dorëzojë fletëkthesën, e cila tregon se kur i ishte dorëzuar parashtrueses së kërkesës Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 277/2014, i 20 nëntorit 2014.
10. Më 26 gusht 2015, Gjykata e pranoi fletëkthesën e kërkuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë që tregon se aktgjykimi i lartpërmendur i Gjykatës Supreme i ishte dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 2 janar 2015.
11. Më 8 mars 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Parashtruesja e kërkesës nga viti 1983 deri më 1999 kishte qenë në marrëdhënie pune në shoqatën e zjarrfikësve të Komunës së Prishtinës (në tekstin e mëtejme: punëdhënësi).
13. Më 24 shtator 2007, Gjykata Komunale në Prishtinë kishte obliguar punëdhënësin që parashtruesen ta kthejë në punë në pozitë të njëjtë apo në një pozitë tjetër me detyra të ngjashme. Më 7 dhjetor 2007, aktgjykimi mori formën e prerë.
14. Si rezultat i këtij aktgjykimi, më 11 shkurt 2008, parashtruesja ishte kthyer në punë.
15. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesja kishte paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë, nëpërmjet të cilës kishte kërkuar kompensim për pagat e humbura nga 1 korriku 1999 deri në datën e kthimit të saj në punë.
16. Më 5 prill 2011, Gjykata Komunale (Aktgjykimi C1. nr. 115/08) në Prishtinë aprovoi padinë e parashtrueses dhe detyroi punëdhënësin e saj t'ia kompensojë pagat e humbura për periudhën kohore: 1 korrik 1999 deri në datën e kthimit të saj në punë.
17. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, punëdhënësi kishte paraqitur ankesë.
18. Më 13 qershor 2014, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi Ac. nr. 2517/2012) refuzoi ankesën e punëdhënësit dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë.
19. Kundër aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, punëdhënësi kishte paraqitur revizion në Gjykatën Supreme.
20. Më 20 nëntor 2014, Gjykata Supreme (Aktgjykimi, Rev. nr. 277/2014) aprovoi pjesërisht si të bazuar revizionin e parashtruar nga punëdhënësi dhe ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe atë të Gjykatës Komunale në Prishtinë.
21. Nëpërmjet aktgjykimit të saj, Gjykata Supreme vendosi që pjesërisht të pranojë si të bazuar padinë e parashtrueses, duke detyruar punëdhënësin që asaj t'ia kompensojë pagat e humbura vetëm për periudhën kohore prej 7 dhjetorit 2007 deri më 11 shkurt 2008. Në të njëjtën kohë, Gjykata Supreme refuzoi si të pabazuar pjesën tjetër të padisë së parashtrueses për kompensimin e pagave të humbura për periudhën kohore prej 1 korrikut 1999 e deri më 7 dhjetor 2007.

Pretendimet e parashtruesit

22. Ashtu si u përmend më lart, parashtruesja, në kërkesën e saj, pretendon se Gjykata Supreme ka shkelur të drejtën e saj për pronë.

23. Parashtruesja e kërkesës pohon se “[...] ka pasur pritje legjitime që do të gëzojë dëmshpërblim në shumën e lartpërmendur sipas të drejtës së kthimit në punë”.
24. Në fund, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata që të anulohet aktgjykimi i Gjykatës Supreme dhe lënda të kthehet në rigjykim.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili përcakton:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.

27. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(c) kërkesa parashtrohet brenda 4 (katër) muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi [...].”

28. Për të përcaktuar nëse parashtruesja e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të paraparë kohor prej 4 (katër) muajsh, Gjykata i referohet ditës kur parashtrueses së kërkesës i është dorëzuar vendimi përfundimtar dhe ditës në të cilën kërkesa është dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese.
29. Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme (Rev. Nr. 277/2014, i 20 nëntorit 2014) i ishte dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 2 janar 2015, ndërsa ajo parashtroi kërkesën e saj në Gjykatë më 26 qershor 2015. Bazuar në këtë, rrjedh se kërkesa nuk është parashtruar brenda afatit ligjor të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.
30. Gjykata përkujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit si dhe rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë sigurinë juridike duke siguruar që rastet të cilat paraqesin çështje kushtetuese të shqyrtohen brenda afateve të arsyeshme, si dhe që vendimet e nxjerra më herët të mos jenë pafundësisht të hapura për kontestim (Shih rastin *O’Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 23274/04, GJEDNJ, Vendim i 25 gushtit 2005).

31. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtrueses është e papranueshme sepse është e pasafatshme.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, më 8 mars 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Altay Suroy



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi